“Kur ta shihni hënën e Ramazanit, agjëroni, e kur ta shihni hënën e shevalit, hani (bëni Bajram). Nëse është vranët (dhe nuk e shihni), plotësojeni muajin (tridhjetë ditë).”

Ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Kur ta shihni hënën e Ramazanit, agjëroni, e kur ta shihni hënën e shevalit, hani (bëni Bajram). Nëse është vranët (dhe nuk e shihni), plotësojeni muajin (tridhjetë ditë).”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti në këtë hadith e sqaroi shenjën e hyrjes dhe daljes së muajit Ramazan, duke thënë: "Kur ta shihni hënën e re të Ramazanit, agjëroni, e nëse mes jush dhe saj ka re dhe nuk mund ta shihni, atëherë plotësojeni muajin Shaban tridhjetë ditë. E kur ta shihni hënën e re të Shevalit, prisheni agjërimin. Ndërsa, nëse mes jush dhe saj ka re dhe nuk mund ta shihni, atëherë plotësojeni muajin Ramazan tridhjetë ditë.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/4549

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee